

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Deklarata - Balliu: KAYO nën hetim parlamentar! Ron Yeffet lidhje me grupin e strukturuar të AKSHI-t dh e rrethin e ngushtë të Ramës
ADRESA	https://www.syri.net/politike/916505/balliu-kayo-nen-hetim-parlamentar-ron-yeffet-lidhje-me-grupin-e-strukturuar-te-akshi-t-dhe-rrethin-e-ngushte-te-rames/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 09:10:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 08:53:25 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	32c2069d2bc0f8db67d2eb4d9e0c7b6290e4f8de477b5629c07672fadc43bed9
TEKSTI	c6bc5f2f057f47db0181b54317a186d6c93592df34fcff0fd32f04d3347ff1a8
PAMJA	c5e991029bbf0df4e6398de5be3102b6374d82cfe2578210ccc539d636b812fb

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b823803ec2b6854bc05a472245eeb57759e1680b3b574a387638d398095102eb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	a9dba7e1cf5e08da052e8f7bcad4dfd2bc0436d1ed5e23cf11abc817a3e1dcfc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b823803ec2b6854bc05a472245eeb57759e1680b3b574a387638d398095102eb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



IRENA BEQIRAJ

Fashizmi nuk duhet kërkuar tek revolta e protestuesve por në Kuvend!



AGIM XHAFKA

Dialog me mbesën

më të lexuarat

Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20 kompani, kanë marrë monopolin në disa fusha

Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin

'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre

Berisha në Konventën Republikane në Dallas - Takime me drejtues të Departamentit të Drejtësisë, Takime me senatore

Shqiptari nga Anglia: Rama dha urdhër të mos hyjmë në shesh! Të rimë këtu derisa ta shporrim nga zyra antishqiptarin

Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhduket historia



Balliu: KAYO nën hetim parlamentar! Ron Yeffet lidhje me grupin e strukturuar të AKSHI-t dhe rrethin e ngushtë të Ramës

10:53, 14/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Partia Demokratike ripërsërit kërkesën për ngritjen e një komisioni hetimor për KAYO-n. Në një prononcim për median nga kuvendi, deputeti demokrat Klevis Balliu, i cili mban dhe postin e nënkryetarit të Komisionit të Sigurisë ka bërë të ditur depozitimin e kërkesës për ngritjen e një Komisioni Hetimor Parlamentar për KAYO-n.

Ai nënvizon se zhvillimet e fundit kanë ngritur pikëpyetje serioze që lidhen me sigurinë kombëtare, kontrollin shtetëror dhe aktivitetin e kompanisë në sektorin e armëve dhe teknologjisë ushtarake dhe se 'ato që po dalin në dritë, nuk mund të trajtohen më si një çështje e zakonshme administrative'.

Balliu deklaroi se rezulton se emri Ron Yefet është i përfshirë në hetimet që lidhen me grupin e strukturuar kriminal në dosjen e AKSHI-t dhe bën thirrje SPAK për të nisur hetimet.

"SPAK duhet të verifikojë çdo lidhje të mundshme mes Ron Yefet, Ergys Agasit, Ekos Resort, Timak Horse Club dhe personave e subjekteve të përfshira në dosjen e AKSHI-t. Sepse nëse këto marrëdhënie janë të ligjshme, transparenca duhet t'i sqarohet"

Duke vënë në dukje se kemi një çështje që prek drejtpërdrejt sigurinë kombëtare, reputacionin ndërkombëtar të Shqipërisë dhe detyrimet tona si vend anëtar i NATO-s, Balliu thotë se Parlamenti ka detyrimin kushtetues të kontrollojë me kontrollin parlamentar dhe të zbardhë përgjegjësinë politike dhe institucionale.

"Ne nuk po kërkojmë që parlamenti të bëjë punën e SPAK-ut. Përkundrazi, SPAK duhet të hetojë çdo dyshim për vepra penale. Parlamenti ka detyrimin kushtetues të kontrollojë me kontrollin parlamentar dhe të zbardhë përgjegjësinë politike dhe institucionale. Komisioni hetimor duhet të verifikojë nëse janë respektuar ligji dhe procedurat, nëse ka pasur kontroll real shtetëror, nëse janë respektuar rregullat për importin dhe eksportin e armëve, detyrimin ndërkombëtar dhe interesat e sigurisë kombëtare. Dhe qeveria ka vetëm një rrugë: të votojë pro komisionit hetimor dhe të hapë çdo dokument. ...Sepse kur bëhet fjalë për armë, para publikës dhe sigurisë kombëtare, askush nuk mund të jetë i njëzini. As Edi Rama"

publike dhe sigurime kombëtare, askush nuk mund të jetë mbi ligjin. As Edi Rama, as njerëzit e tij, asnjë kompani private. Shteti shqiptar nuk mund të jetë mburojë për askënd" theksoi Balliu.

Deklarata e plote

"Kemi përballë një kompani shtetërore që operon në një sektor strategjik, atë të armëve, municioneve dhe teknologjisë ushtarake. Kemi partneritete ku shteti shqiptar ngre pikëpyetje mbi kontrollin dhe pozicionin e tij. Kemi kontrata dhe pagesa me vlera të konsiderueshme, kemi pikëpyetje serioze mbi përzgjedhjen e partnerëve dhe mbi të gjitha, kemi materiale të bëra publike që kërkojnë verifikim të plotë mbi dyshimet për një skemë të mundshme të trafikimit, importimit dhe ripaketimit të armëve.

Dhe në qendër të këtyre pikëpyetjeve shfaqet emri Ron Yefet, një person që është lidhur publikisht me rrethin e Edi Ramës dhe me vetë Edi Ramën dhe që rezulton të jetë i përfshirë në marrëdhënie biznesi që lidhen me strukturat të Kajos. Për këtu shfaqet edhe një tjetër element që kërkon përgjigje.

Gjithashtu rezulton se emri Ron Yefet është i përfshirë në hetimet që lidhen me grupin e strukturuar kriminal në dosjen e AKSHI-t.

Nëse kjo rrethanë konfirmohet nga organet kompetente, ajo e bën edhe më të domosdoshme verifikimin e plotë të marrëdhënieve të tij ekonomike dhe institucionale. Në këtë kontekst, një tjetër fakt që kërkon shpjegim është krijimi më 23 mars 2026 i shoqërisë Timak Horse Club, me pronar përfitues Ron Yefet dhe lidhja e aktivitetit të saj me Ekos Resort në Petrelë. Kronologjia kërkon vëmendje të veçantë.

Krijimi i kësaj kompanie ndodh vetëm pak javë përpara sekuestrimit të pasurive të lidhura me Ergys Agasin dhe pak ditë përpara ekzekutimit të sekuestrimit në Ekos Resort.

Kjo kronologji në vetvete nuk përbën provë të një vepre penale, por është një rrethanë konkrete që kërkon verifikim të plotë dhe shpjegim nga institucionet e drejtësisë. Pyetjet janë të qarta. Çfarë lidhje ka Ron Yefet me Ergys Agasin dhe rrjetin e Ekos Resort? Kush i dha të drejtën e përdorimit të këtij kompleksi? A ka pasur kontrata, pagesa, marrëveshje apo transaksione mes tyre? Çfarë marrëdhënie ka kjo kompani me aktivitetet e tjera të personave dhe subjekteve që janë nën hetim? Dhe a ka ndonjë lidhje mes këtyre marrëdhënieve dhe çështjeve të hetuara në dosjen e AKSHI-t? Këto nuk janë pyetje që mund të mbyllen me propagandë politike.

SPAK duhet të verifikojë çdo lidhje të mundshme mes Ron Yefet, Ergys Agasit, Ekos Resort, Timak Horse Club dhe personave e subjekteve të përfshira në dosjen e AKSHI-t. Sepse nëse këto marrëdhënie janë të ligjshme, transparencja duhet t'i sqarohet.

Nëse nuk janë të ligjshme, drejtësia duhet të veprojë. Kjo nuk është më një histori për të fshehur pas propagandës qeveritare. Nëse rezulton se një kompani shqiptare është përdorur për të importuar armë nga vende të treta, për t'i ripaketuar apo paraqitur në një formë tjetër dhe më pas për t'i futur në tregjet ndërkombëtare, atëherë nuk kemi më përpara një problem të thjeshtë ekonomik. Kemi një çështje që prek drejtpërdrejtë sigurinë kombëtare, reputacionin ndërkombëtar të Shqipërisë dhe detyrimet tona si vend anëtar i NATO-s.

Dhe disa pyetje lindin pikërisht nga kjo çështje. Çfarë roli ka pasur Ron Yefet? Kush e ka ofruar me këtë strukturë? Kush e ka sjellë në marrëdhëniet me institucionet shqiptare? Kush ka negociuar? Kush ka firmosur? Kush ka kontrolluar armët që kanë hyrë dhe kanë dalë nga territori shqiptar? Dhe mbi të gjitha, a ka pasur Edi Rama dijeni për këto marrëdhënie dhe aktivitete? Sepse nuk mund të ndërtojmë një shtet ku njerëzit pranë pushtetit shfaqen në marrëdhënie me biznese strategjike, ku shteti financon, garanton dhe vendos në dispozicion asetet publike, ndërsa kur lind pyetja mbi përgjegjësinë, papritur askush nuk di asgjë. Ne nuk po kërkojmë që parlamenti të bëjë punën e SPAK-ut. Përkundrazi, SPAK duhet të hetojë çdo dyshim për vepra penale. Parlamenti ka detyrimin kushtetues të kontrollojë me kontrollin parlamentar dhe të zbardhë përgjegjësinë politike dhe institucionale. Komisioni hetimor duhet të verifikojë nëse janë respektuar ligji dhe procedurat, nëse ka pasur kontroll real shtetëror, nëse janë respektuar rregullat për importin dhe eksportin e armëve, detyrimet ndërkombëtare dhe interesat e sigurisë kombëtare.

Dhe qeveria ka vetëm një rrugë: të votojë pro komisionit hetimor dhe të hapë çdo dokument. Nëse nuk ka asgjë për të fshehur, pse duhet të trembet nga hetimi parlamentar? Nëse KAYO është krijuar për interesin e mbrojtjes së vendit, pse lindin kaq shumë pikëpyetje mbi kontrollin real të shtetit mbi këtë sektor strategjik?

'Po blejnë influencë te zyrtarët e BE',
Xhaferri: Rama i mori 17 miliardë lekë
Universitetit të Tiranës për Kolegjin e
Evropës

SYRI TV/ Karakaçi: TEC-et do jenë
pronë e KESH, ERE ka shtyrë licencimin
e tyre

'Diaspora nuk ka për t'ia falur Ramës!
Shqiptarët e bashkuar pushteti i tmerruar!
Dita e 105 e protestës në foto

Dhe nëse gjithçka është e ligjshme, pse vazhdojnë të mbeten pa përgjigje pyetjet mbi Ron Yefet, KAYO-n, marrëdhëniet me Ergys Agasin, Ekos Resort, dosjen e AKSHI-t dhe rrethin e ngushtë të Edi Ramës. Ne nuk do të lejojmë që siguria kombëtare të kthehet në një biznes privat, ndërsa institucionet shqiptare të përdoren si perde për marrëdhënie të paqarta. Kajo duhet të hetohet. Roli i Ron Yefet duhet të verifikohet.

Marrëdhëniet me institucionet shtetërore duhet të zbardhen. Lidhjet me Ergys Agasin, Ekos Resort dhe dosjen e AKSHI-t duhet të hetohen, dhe çdo përgjegjësi politike apo penale duhet të dalë para drejtësisë. Sepse kur bëhet fjalë për armë, para publike dhe sigurinë kombëtare, askush nuk mund të jetë mbi ligjin. As Edi Rama, as njerëzit e tij, asnjë kompani private. Shteti shqiptar nuk mund të jetë mburojë për askënd.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Rama kërcënon shqiptarët në Miçigan/ Reagon PD: Dënojmë me forcën më të madhe terrorin psikologjik



Kurti me premtime të mëdha: 1 mld euro për prodhimin, paga mbi 1 mijë euro



Cenon lirinë e medias, Rregullorja e Brendshme e GJKKO-së përfundon në Gjykatë Kushtetuese

TË NGJASHME



Muzeu hebraik në Vlorë/ Nezini: Godina i përket Klubit Labëria, po zhduket historia



'Mafia emëron ministrat në qeverinë Rama', Kepi: E kanë të lehtë të gjejnë personin e duhur për aferat e tyre



Zhupa: Nga shkollat me turne te emigrimi i të rinjve, problemet mbeten të njëjta, fëmijët paguajnë çmimin



AKEP ndalon klauzolat e indeksimit, rritja e çmimit të celularëve duhet të parashikohet në vlerë



Shifra tronditëse/ BE ka dhënë 1.1 milionë leje qëndrimi për shqiptarët, Gjermania arrin rekordin



'Ministrat, kukulla të Ramës', Mziu: Jo më kot kryeministri përzgjedh persona anonimë



Berisha: Shqipëria po përballet me një krizë të thellë demografike, 5,900 nxënës më pak në vetëm një vit

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net